



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 940/

Tirane, date 26.12./2015

**Drejtuar: SHOQERISE "GRUPPO MINERARIO ALBANEZE" SH.P.K
URA E SKURAJT, MILOT, KURBIN**

LEZHE

**Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"**

TIRANE

**Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE**

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.976 date 04.12.2006.

Te nderuar zotërinj,

Shoqëria "Gruppo Minerario Albaneze" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.976 date 04.12.2006, për bazaltë, Mirdite, ne Qarkun Lezhe.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2019 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.940 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.976 date 04.12.2006, për bazaltë, Mirdite, ne Qarkun Lezhe, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2012-2013, për vitin 2013-2014 dhe vitin 2014-2015.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.976 datë 04.12.2006, për bazaltë, Mirdite, në Qarkun Lezhë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.976 datë 04.12.2006.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minierar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

